



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 07.10.2021, merr këtë:

VENDIM

për akreditim të grupit shtesë të vëzhguesve të "NISMA Socialdemokrate" (NISMA)

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për akreditimin e grupit të Vëzhguesve shtesë të partisë politike "NISMA Socialdemokrate" me 441 vëzhgues afatshkurtër, për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më 17 tetor 2021.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë partinë politike "NISMA Socialdemokrate" me obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre që rrjedhin nga neni 4 i Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftoj partinë politike "NISMA Socialdemokrate" për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Lista e vëzhguesve shtesë të partisë politike "NISMA Socialdemokrate" është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.